

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË “CRA Group Albania” SHPK

Sot, më 01.02.2024, në qytetin e Tiranës, Shqiperi, ortakët e mëposhtëm themelues, personat fizik:

- 1) **Alvari Kamxhiu**, shtetas shqiptar, lindur me 24.01.2001, ne Fiershegan, ALB me numer personal K10124082W dhe banues ne Fiershegan, Lushnje
- 2) **Arber Hoxha**, shtetas shqiptar, lindur me 22.09.1981, ne Puke, ALB, me numer personal I10922088N dhe banues ne Tirane.
- 3) **Kelmend Hodaj**, shtetas shqiptar, lindur me 25.09.1988, ne Fier, ALB, me numer personal I80925109Q dhe banues ne Tirane
- 4) **Marioglen Xhumari**, shtetas shqiptar, lindur me 31.01.1989, ne Lushnje, ALB, me numer personal I90131018Q dhe banues ne Tirane

me vullnet të plotë, të lirë e të pacenuar, nënshkruajnë këtë Akt Themelimi, në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), nëpërmjet të cilit Ortakët Themelues shprehin vullnetin të themelojnë shoqërinë “**CRA Group Albania**” SHPK, me kushtet si vijon:

NENI 1

Emri i shoqërisë

- 1.1. Emri i shoqërisë do të jetë “CRA Group Albania” SHPK.
- 1.2. Ortakët Themelues të shoqërisë mbajnë përgjegjësi të kufizuar deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara të kapitalit bazë të shoqërisë.

NENI 2

Forma e shoqërisë

- 2.1. Forma e shoqërisë tregtare “CRA Group Albania” SHPK (*referuar në vijim si “Shoqëria”*) do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar).
- 2.2. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 3

Selia e shoqërisë

- 3.1. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Rruga “Mine Peza”, godina numer 3, hyrja numer 4, apartamenti numer 25, përballë Hotel “TAFAJ”, Tirane.
- 3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjetër brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 4

Kohëzgjatja e Shoqërisë



- 4.1. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat kohor të pakufizuar, i cili fillon me regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, nëpërmjet një vendimi të posaçëm.

NENI 5

Objekti i veprimtarisë

- 5.1. Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në të:

- *Sherbim dhenie makinash (automjete) me qera ditore, mujore dhe vjetore, per personat individe, fizik dhe personat juridik.*
- *Sherbime shitje biletash avioni, trageti dhe bileta te tjera udhetimi.*
- *Sherbime marketingu dhe reklame.*
- *Sherbime konsulence dhe ndermjetesimi ne sektorine imobilar per pasurite e paluajshme, me personat individe, fizik dhe personat juridik.*

NENI 6

Kapitali dhe Kuotat e Shoqërisë

- 6.1. Kapitali bazë i shoqërisë është në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë dhe ndahet në 4 të cilat zotërohen nga Ortakët Themelues në kuotat e mëposhtme:
- i. 1 (një) kuotë e zotëruar nga ortaku Alvaro Kamxhiu, me vlerë nominale prej 25.000 (njetzet e pesë mijë) lekë, e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes prej 25% në kapitalin bazë të shoqërisë;
 - ii. 1 (një) kuotë e zotëruar nga ortaku Arber Hoxha me vlerë nominale prej 25.000 (njetzet e pesë mijë) lekë, e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes prej 25% në kapitalin bazë të shoqërisë.
 - iii. 1 (një) kuotë e zotëruar nga ortaku Kelmend Hodaj me vlerë nominale prej 25.000 (njetzet e pesë mijë) lekë, e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes prej 25% në kapitalin bazë të shoqërisë.
 - iv. 1 (një) kuotë e zotëruar nga ortaku Marioglen Xhumari me vlerë nominale prej 25.000 (njetzet e pesë mijë) lekë, e cila i jep të drejtën e pjesëmarrjes prej 25% në kapitalin bazë të shoqërisë.
- 6.2. Kapitali bazë i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar në tërësinë e tij nga Ortakët Themelues.

NENI 7

Organet Drejtuese

- 7.1. Bazuar në dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë:
1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve — organi më i lartë vendimmarrës;
 2. Administratori — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.
- 7.2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 8



Administrimi

- 8.1. Shoqëria do të administrohet nga Administratori i saj, i cili mund të emërohet për një afat deri në pesë vjet me të drejtë riemërimi.
- 8.2. Administrator i vetëm i shoqërisë “CRA Group Albania” SHPK do të jetë **Z. Alvaro Kamxhiu** me shtetësi shqiptare, lindur në datë 24.01.2001 e banues në Lushnje, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit me nr.personal: K10124082W, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.
- 8.3 Administratori i sipërcituar emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar me të drejtë riemërimi, duke nisur ky afat nga data e regjistrimit të tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 8.4. Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, apo nga një ose disa persona të autorizuar prej tij.

NENI 9

Ligji i aplikueshëm

- 9.1. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ky akt themelimi, si dhe parashikimet e Statutit të saj.

NENI 10

Regjistrimi

- 10.1. Shoqëria do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga administratori dhe/ose një/disa person(a) të autorizuar prej tij për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 11


Dispozitat përfundimtare

- 11.1 Ky Akt Themelimi hartohet në 6 (gjashte) kopje në shqip dhe nënshkruhet nga Ortakët Themelues të shoqërisë “CRA Group Albania” SHPK.

ORTAKË THEMELUES:

1. **Alvaro Kamxhiu**

Alvaro Kamxhiu



2. **Arber Hoxha**

Arber Hoxha



3. **Kelmend Hodaj**

KELMEND HODAJ



4. **Marioglen Xhumari**

Marioglen Xhumari

